

VENDIM

Nr 158, Datë 13/02/2008

PËR IMPORT-EKSPORTIN E BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes , të pikës 3 të nenit 82, të ligjit Nr.8449, datë 27.01.1999, “ Kodi doganor në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 3 dhe 7 të ligjit nr. 8025, datë 9/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, me propozim të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

Vendosi.:

1.Burimet radioaktive që do t'i nënshtrohen proceduarave të import-eksportit, si dhe pajisjet dhe sistemet ku ato inkorporohen, janë përcaktuar në listën e miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

2.Veprimet në pikat doganore për import- eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues kryehen vetëm pasi personat, fizikë apo juridikë, të kenë paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Licensë për veprimtari import-eksporti me burime të rrezatimit jonizues, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

b)Leje për import-eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues, përkatësisht:

-Për burimet e kategorive 1 dhe 2, lëshuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

-Për burimet e kategorive 3,4 e 5 dhe gjeneratorëve me rreze X, të lëshuar nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

c)Certifikatën e cilësisë së gjeneratorëve me rreze x, lëshuar brenda dy viteve të fundit, nga casti i importimit.

3. Vendimi nr.56, datë 24.02.2000, i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren Zyrtare

Kryeministri
Sali BERISHA